



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Integrimin European***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 28.05.2019, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Rudina Hajdari - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 03.04.2019.
2. Raportit vjetor të Këshillit Kombëtar të Integritimit European.

**Marrin pjesë:**

Rudina Hajdari, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Sadri Abazi, Ralf Gjoni, Aurora Mara, Andrea Marto

**Mungojnë:**

Senida Mesi, Fatmir Velaj, Arben Kamami, Klodiana Spahiu , Suzana Topi

## HAPET MBLEDHJA

**Rudina Hajdari** – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 03.04.2019.

A jeni dakord me procesverbalin? Dakord.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës për ditën e sotme është shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian për vitin 2018. Për të shqyrtuar raport dhe për të thënë diçka më tepër për këtë raport, po ia kaloj fjalën nënkryetarit të Komisionit, zotit Balla.

**Taulant Balla** - Së pari, do të doja ta uroja zonjën Hajdari për detyrën e kryetares së Komisionit dhe siç parashikon ligji “Për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritetit europian”, përkatësisht për Këshillin Kombëtar të Integritetit, kryetari i Komisionit të Integritetit është automatikisht edhe kryetar i Këshillit, ndërsa në cilësinë e kryetarit të Komitetit Ndërparlamentar të Stabilizim-Asocimit Shqipëri-BE, unë mbaj detyrën e nënkryetarit të Këshillit Kombëtar. Pa dyshim që Këshilli Kombëtar për Integritetin Europian, përgjatë vitit 2018, parashikuar edhe në ligjin që citova më sipër, ka për detyrë të raportojë në Komisionin e Integritetit e më pas në seancë plenare për punën e kryer gjatë vitit bashkë me një program pune për vitin 2019 të konsultuar me të gjithë anëtarët, të ftuarit e përhershëm të Këshillit Kombëtar për Integritetin Europian.

U kujtoj të gjithë atyre që nuk e dinë, se Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian është i vetmi institucion që bën bashkë të gjitha institucionet e tjera, duke filluar nga Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, institucionet e pavarura, shoqëria civile, sindikatat dhe, si i tillë, ka një peshë të rëndësishme në kuadër të aspiratës sonë historike për integritetin në BE.

Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian, bazuar në këtë mision gjithëpërfshirës, i ka kushtuar vëmendje rolit të rëndësishëm që luan në drejtim të garantimit të bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet forcave politike dhe institucioneve publike, por veçanërisht bashkëpunimit me shoqërinë civile, botën akademike dhe të gjitha grupet e interesit të shoqërisë. Për këtë qëllim janë marrë në shqyrtim dokumente të rëndësishme strategjike me synim diskutimin dhe mbikëqyrjen e detyrimeve të reformave të nevojshme në kuadër të përgatitjes për fillimin e bisedimeve për anëtarësim mes BE-së dhe Shqipërisë.

Gjithashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe forcimit të kapaciteteve të të gjithë aktorëve, përfshirë edhe procesin e integritetit, përfaqësuesit e administratës publike dhe asaj vendore në veçanti, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të medias dhe të biznesit për detyrimet dhe sfidat që përshin anëtarësimi në BE.

Megjithatë, unë dua të jem i hapur sot në këtë raportim dhe theksoj faktin se veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Integritimit European gjatë vitit 2018 është prekur dhe dëmtuar nga bojkoti i vazhdueshëm i Kuvendit nga opozita, ndonëse rregullorja e Këshillit Kombëtar të Integritimit European e përcakton qartë detyrimin që ka ky Këshill për t'u mbledhur të paktën çdo dy muaj gjatë vitit 2018, kjo gjë nuk ka ndodhur dhe nuk është përmbushur si detyrim. E kam theksuar atëherë dhe vazhdoj t'i qëndroj mendimit se, në fazën e përparuar, në të cilën ndodhet procesi ynë i integritimit european, kërkohet rritja dhe forcimi i gjithëpërfshirjes në hartimin dhe në monitorimin e reformave integruese. Nxitja dhe lehtësimi i dialogut publik për zbatimin dhe cilësinë e këtyre reformave, si dhe informimi sa më korrekt i shoqërisë lidhur me sfidat dhe përfitimet në procesin e integritimit janë vendimtare në konsolidimin e konsensusit mbarëshoqëror mbi këtë proces.

Ne politikanët shqiptarë duhet t'u jemi mirënjohës qytetarëve që jemi i vetmi vend në Europë, i cili gëzon mbi 94 % të mbështetjes popullore për sa i përket qasjes sonë proaktive europiane. Për këtë qëllim, do të ishte e nevojshme që jo vetëm Këshilli të ishte mbledhur më shpesh, madje më shumë se sa e parashikon rregullorja, por edhe roli i tij të forcohej më tej, me qëllim mbikëqyrjen sa më efektive të ecurisë së procesit të integritimit european të Shqipërisë.

Unë jam shpresëplotë që, nën drejtimin e zonjës Hajdari, ky detyrim do të plotësohet tërësisht. Nisur nga ky synim, për aq kohë sa kam drejtuar Këshillin Kombëtar të Integritimit në cilësinë e nënkryetarit (në mungesë të kryetarit) jam përpjekur t'i rikthej rëndësinë këtij Këshilli, duke organizuar takime dhe konsultime të shpeshta me të gjitha grupet e interesit të përfshira në këtë forum të rëndësishëm dhe shpreh bindjen që veprimtaria e Këshillit gjatë vitit 2019 do të reflektojë sfidat e këtij momenti kaq të rëndësishëm të procesit të integritimit, duke u kthyer në një forum dialogu e konsultimi gjithëpërfshirës, në mbështetje të avancimit të axhendës europiane të vendit. Thënë kjo, pavarësisht problematikave, veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Integritimit European gjatë vitit 2018 është zhvilluar kryesisht në dy drejtime kryesore: së pari, në monitorimin e zbatimit të detyrimeve të procesit të integritimit, dhe, së dyti, në kontributin për rritjen e kapaciteteve për çështjet e integritimit european.

Raporti është i gjatë dhe do t'u kërkoja të gjithë anëtarëve të Komisionit të Integritimit ta shfletojnë me kujdes!

Në mbyllje të fjalës sime, dua të them se është një rastësi e bukur që ky raport shqyrtohet në Komisionin e Integritimit një ditë para se Komisioni European të publikojë progresraportin për vendet e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë të veçantë për Shqipërinë, ku pritshmëritë tona, bazuar mbi ato që kemi arritur të bëjmë dhe mbi reformat e suksesshme të ndërmarra deri tani, janë që nesër në mesditë Komisioni European të rekomandojë, ashtu si një

vit më parë, fillimin e menjëhershëm të bisedimeve mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut me BE-në. Po aq rastësi e bukur është që në Kuvendin e Shqipërisë ky raport shqyrtohet një ditë pasi ky progresraport dhe ky rekomandim pozitiv të bëhen publik dhe në ditën kur përfaqësuesit e BE-së, këtu në Tiranë, u dorëzojnë autoriteteve vendore raportin e plotë.

Duke e përmbyllur, dua të them se duhet të jemi të gjithë të bindur se Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian duhet të marrë peshën që i ka dhënë ligji dhe rëndësinë që ka. Unë jam bashkëfirmëtar i këtij ligji, sepse e kemi miratuar me zonjën Bregu dhe është një model që ka funksionuar më së miri në vende që kanë pasur sukses në rrugën europiane. Modeli i Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian është i njëjtë me atë kroat dhe është një instrument, i cili bën bashkë maxhorancën dhe opozitën në Kuvend përtej spektrit politik.

Faleminderit!

**Rudina Hajdari** – Faleminderit, zoti Balla për trajtimin shterues!

Do të doja ta hapja diskutimin nëse ka ndonjë koment apo pyetje nga anëtarët!

**Ralf Gjoni** –Faleminderit!

Së pari, do të doja të shprehja vullnetin tim si deputet i opozitës, por edhe si grup parlamentar i pavarur në favor të të gjithë aktivitetit parlamentar, që lidhet me procesin e integritimit europian të Shqipërisë. Mendoj se kur vjen puna për integrimin europian të vendit, nuk duhet të ketë politikë të brendshme, por bashkim të forcave tona për të rritur sa më shumë cilësinë e përfaqësimit të Shqipërisë pranë strukturave të BE-së.

Mendoj se një nga problematikat më të mëdha, që nuk del mjaftueshëm qartë nga raporti, por duket qartë nga aktiviteti i vitit të shkuar, që, për mendimin tim, ka qenë i cunguar për shkak të krizës politike, por edhe të mungesës së vullnetit për ta çuar përpara aktivitetin e Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, është mungesa e theksuar e kapaciteteve profesionale të administratës publike të shtetit shqiptar, të institucioneve kyçe që merren me integrimin për t'u përballur në mënyrë profesionale dhe dinjitoze me procesin tepër të dhimbshëm, do ta quaja, të negociatave, kur të vendosen të hapen. Kjo është një nga problematikat me të cilat ne do të përballemi edhe në hapjen e procesit të negociatave.

Unë mendoj që, jo vetëm Komisioni i Integritimit, por edhe Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian gjatë vitit dhe muajit të ardhshëm, duhet të ushtrojnë më tepër presion ndaj ekzekutivit dhe ndaj të gjitha institucioneve, që lidhen me fuqinë ekzekutive në vend, për forcimin e kapaciteteve profesionale veçanërisht lidhur me procesin e negociatave. Nuk kemi mjaftueshëm profesionistë, ekspertë ligjorë apo të integritimit për sa i përket përballjes me këto negociata.

Kontributi ynë në këtë Këshill dhe në këtë komision, si opozitë do të jetë konstruktiv, por me një dozë të fortë kritike për ato hallka kyçe në procesin e integritimit. Mendoj se ky

kontribut do të jetë në funksion të transformimit të Këshillit Kombëtar të Integritit Europian në një bërthamë qendrore të të gjithë aktivitetit institucional bashkë me aktorët ekstrainsitucionalë, sidomos me shoqërinë civile, për të siguruar një mbarëvajtje sa më profesionale të procesit të hapjes së negociatave. Shpresojmë shumë që këto negociata të hapen sa më shpejt brenda muajit qershor, sepse tashmë kjo datë është tepër e vonuar, pasi duhej të ishin hapur më parë, me qëllim që procesi i skarës institucionale nga Brukseli ndaj ekzekutivit shqiptar të fillojë sa më shpejt dhe të ndryshimin real dhe të prekshëm për qytetarët shqiptarë në procesin e integritit.

Faleminderit!

**Rudina Hajdari** – Faleminderit, zoti Gjoni!

A ka ndonjë pyetje ose koment tjetër? Nuk ka.

Mbledhjen sot do ta mbyllim shumë shpejt, por më përpara mendoj se duhet të kalojmë të miratimi i një projektrezolute, e cila mbështet veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Integritit Europian përgjatë vitit 2018, të cilën e keni përpara. Kjo është një risi që vjen në Komisionin e Integritit, sepse siç e tha edhe zoti Balla, duhet të bëjmë më shumë përpjekje për ta shtuar aktivitetin e Këshillit Kombëtar, në mënyrë që procesi i integritit të mbështetet sa më shumë, jo vetëm nga partitë politike, por edhe nga shoqëria civile dhe të kemi një gjithëpërfshirje gjatë këtij procesi.

Nëse nuk ka kundërshtime për projektrezolutën, unë them ta hedhim në votim dhe, pa dyshim kjo rezolutë do të diskutohet edhe në parlamentin e Shqipërisë.

Kush është kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet

Faleminderit shumë! Ditën e mirë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**